

BANKA E SHQIPËRISË

B U L E T I N I
Z Y R T A R

vëllimi 26 numër 4 qershor 2024

Data e botimit: 7.6.2024

P Ë R M B A J T J A

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 26, datë 8.5.2024 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë"	5
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 27, datë 8.5.2024 "Për "Një ndryshim në vendimin nr. 36, datë 25.6.2014 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për miratimin e procedurës së veçantë të prokurimit për përzgjedhjen e audituesit të jashtëm të pasqyrave financiare të Bankës së Shqipërisë dhe të fondit të pensionit suplementar", i ndryshuar"	7
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 28, datë 8.5.2024 "Për miratimin e "Dokumentit të politikës së investimit të fondit të pensionit në Bankën e Shqipërisë"	9
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 29, datë 8.5.2024 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për krahasueshmërinë e tarifave të lidhura me llogaritë e pagesave dhe për shërbimin e transferimit të llogarive të pagesave"	15
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 30 datë 8.5.2024 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për sigurinë e informacionit"	19
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 31, datë 8.5.2024 "Për një ndryshim në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 17, datë 23.3.2023 "Për miratimin e konfigurimeve të vizatimeve të monedhës përkujtimore, që do të shtypet për qëllime numizmatike në vitin 2023"	21
7. Vendim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, nr.prot. 2302, datë 23.5.2024 "Për revokimin e licencës së subjektit financiar jobankë "Micro Credit Albania" SH.P.K."	22
8. Vendim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, nr.prot. 2303, datë 23.5.2024 "Për revokimin e licencës së subjektit financiar jobankë "Final" SH.P.K."	24
9. Urdhër i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, nr.prot. 2454, datë 4.6.2024 "Për hedhjen në qarkullim të monedhave metalike shqiptare, me kurs ligjor, me vlerë nominale 5 Lekë"	26
10. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 32, datë 5.6.2024 "Për miratimin e lirimit nga detyra të drejtorit të Departamentit për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme të Bankës së Shqipërisë"	27
11. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 33, datë 5.6.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka"	28
12. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar, vëllimi 26, numër 1, janar 2024	33
13. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar, vëllimi 26, numër 2, shkurt 2024	33
14. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar, vëllimi 26, numër 3, prill 2024	33



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM
Nr. 26, datë 8.5.2024

PËR
MBAJTJEN E PANDRYSHUAR TË NORMËS SË INTERESIT TË
MARRËVESHJEVE TË RIBLERJES DHE TË ANASJELLA TË RIBLERJES DHE
TË NORMAVE TË INTERESIT TË DEPOZITËS NJËDITORE DHE TË KREDISË
NJËDITORE NË BANKËN E SHQIPËRISË

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronjat "a" dhe "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 3.25 për qind, normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes (REPO dhe REPO të anasjella).
2. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 2.25 për qind, normën e interesit që Banka e Shqipërisë i paguan një banke tregtare për depozitën njëditore.
3. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 4.25 për qind, normën e interesit që një bankë tregtare i paguan Bankës së Shqipërisë për kredinë njëditore.
4. Ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare të njoftojë menjëherë bankat tregtare për këtë vendim.
5. Ngarkohen Departamenti i Operacioneve Monetare dhe të gjitha strukturat e tjera në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

nt Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në faqen zyrtare të internetit dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

KRYETARI

ELVIS ÇIBUKU

GENT SEJKO



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM
Nr. 27, datë 8.5.2024

**PËR
"NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 36, DATË 25.6.2014 TË KËSHILLIT
MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR MIRATIMIN E PROCEDURËS
SË VEÇANTË TË PROKURIMIT PËR PËRZGJEDHJEN E AUDITUESIT TË
JASHTËM TË PASQYRAVE FINANCIARE TË BANKËS SË SHQIPËRISË DHE TË
FONDIT TË PENSIONIT SUPLEMENTAR", I NDRYSHUAR**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja "g" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; vendimit nr. 38, datë 8.5.2019 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë "Për hartimin dhe auditimin e pasqyrave financiare të Fondit të Pensionit Suplementar të Bankës së Shqipërisë"; me propozim të Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 36, datë 25.6.2014 "Për miratimin e procedurës së veçantë të prokurimit për përzgjedhjen e audituesit të jashtëm të pasqyrave financiare të Bankës së Shqipërisë dhe të Fondit të Pensionit Suplementar", i ndryshuar, pika 2 ndryshon me përmbajtje si më poshtë:

"Të miratojë fondin limit të nevojshëm për prokurimin e objektit "Përzgjedhja e audituesit të jashtëm të pasqyrave financiare të Bankës së Shqipërisë dhe të Fondit të Pensionit Suplementar për vitet 2024-2028" në vlerën totale 41,624,000 (dyzet e një milion e gjashtëqind e njëzet e katër mijë) lekë, përkatësisht 35,000,000 (tridhjetë e pesë milion) lekë për auditimin e pasqyrave financiare të Bankës së Shqipërisë dhe 6,624,000 (gjashtë milion e gjashtëqind e njëzet e katër mijë) lekë për auditimin e pasqyrave financiare të Fondit të Pensionit Suplementar."

2. Ngarkohen Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës dhe Departamenti i Administrimit me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM
Nr. 28, datë 8.5.2024

PËR
MIRATIMIN E "DOKUMENTIT TË POLITIKËS SË INVESTIMIT TË FONDIT TË
PENSIONIT NË BANKËN E SHQIPËRISË"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja "g" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të nenit 19 të rregullores "Për fondin e pensionit suplementar të Bankës së Shqipërisë", miratuar me vendimin nr. 30, datë 27.4.2011 të Këshillit Mbikëqyrës, i ndryshuar; me propozim të Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë "Dokumentin e politikës së investimit të fondit të pensionit në Bankën e Shqipërisë", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare me zbatimin e këtij vendimi dhe dërgimin e "Dokumentit të politikës së investimit të fondit të pensionit në Bankën e Shqipërisë" tek të gjithë punonjësit e siguruar në Fondin e Pensionit.
3. Ngarkohet Komiteti i Administrimit të Fondit të Pensionit me ndjekjen e zbatimit të "Dokumentit të politikës së investimit të fondit të pensionit në Bankën e Shqipërisë".
4. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet "Dokumenti i politikës së investimit të fondit të pensionit në Bankën e Shqipërisë" miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 8, datë 10.2.2010.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO

DOKUMENTI I POLITIKËS SË INVESTIMIT TË FONDIT TË PENSIONIT NË BANKËN E SHQIPËRISË

1. Qëllimi

Qëllimi i dokumentit të politikës është përcaktimi i parimeve të investimit, zbatimit të parimeve nëpërmjet objektivave të investimit, strukturës së mbajtjes së investimeve dhe përbërjes së saj, si dhe i kritereve për mbajtjen nën kontroll dhe minimizimin e rreziqeve.

1. Baza ligjore

Dokumenti i Politikës mbështetet në nenin 43, shkronjën "g" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe të nenit 19 të rregullores "Për fondin e pensionit suplementar të Bankës së Shqipërisë", miratuar me vendimin nr. 30, datë 27.4.2011 të Këshillit Mbikëqyrës, i ndryshuar (Rregullorja për Fondin e Pensionit).

2. Përkufizime

Në këtë dokument, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

- a) Banka – është Banka e Shqipërisë;
- b) Komiteti – është Komiteti i Administrimit të Fondit të Pensionit, i ngritur sipas rregullores "Për fondin e pensionit suplementar të Bankës së Shqipërisë";
- c) Transh – është pjesa e fondit, e krijuar në bazë të një ose disa kritereve specifike;
- d) Rreziku i kreditit – është pasiguria mbi aftësinë e kundërpalës për të paguar detyrimet;
- e) Rreziku i likuiditetit – është rreziku i vështirësisë ose pamundësisë së tregtimit të një instrumenti të caktuar në momentin e kërkuar pa pësuar humbje;
- f) Rreziku i tregut – është rreziku që fondi mund të pësojë humbje si rezultat i luhatjes në çmimet e titujve të investimit të fondit;
- g) Rreziku i agjencisë – është rreziku që menaxherët e fondit nuk do të menaxhojnë fondin duke maksimizuar interesin e anëtarëve;
- h) Rreziku operacional – është rreziku i humbjeve të shkaktuara nga dështimi apo gabimet në procese, procedura, sisteme dhe njerëz;

- i) ISIN (*International Security Identification Code*) – është një numër unik i përbërë nga 12 karaktere alfanumerike, i cili shërben për të njohur titullin ndërkombëtarisht;
- j) Dorëzim kundrejt pagesës (DVP) - është parimi, i cili siguron shlyerjen përfundimtare dhe të pakthyeshme të një transaksioni instrumentesh financiare, ku transferta e pakthyeshme dhe e pakushtëzuar e instrumenteve nga shitësi tek blerësi, ndodh vetëm nëse ndodh transferimi i pakthyeshem dhe i pakushtëzuar i fondeve nga blerësi tek shitësi;
- k) Parimi i katër syve – parim përmes të cilit çdo e dhënë e re e hedhur në sistem do të duhet të aprovohet nga një përdorues i sistemit i ndryshëm nga hedhësi i të dhënës.

3. Parimet e investimit

Mjetet e fondit investohen në interesin më të mirë afatgjatë të anëtarëve, si dhe duke respektuar parimet e sigurisë së aseteve të fondit, diversifikimit të portofolit dhe mbajtjes së likuiditetit të përshtatshëm.

4. Objektivat e investimit në zbatim të parimeve

Investimi i aktiveve të fondit do të kryhet duke synuar arritjen e objektivave të mëposhtëm:

- a) Disponueshmërinë e fondeve të mjaftueshme për të përmbushur nevojat për pagesa pensionale në kohën e përcaktuar;
- b) Ruajtjen e vlerës së fondit, në tërësinë e tij, nëpërmjet mbajtjes nën kontroll në një mënyrë sa më të kujdesshme të rrezikut të likuiditetit, të tregut, të kreditit dhe atij operacional;
- c) Gjenerimin e të ardhurave, në përputhje me objektivat e investimit dhe administrimit të rreziqeve, për sa kohë nuk bie ndesh me shkronjat "a" dhe "b" të kësaj pike.

5. Struktura e aktiveve të fondit të pensionit

5.1 Struktura e aktiveve të fondit të pensionit përbëhet nga:

- a) fondi i përfitimeve;
- b) fondi i investueshëm.

5.2 Pjesa e fondit të përfitimeve është e barabartë me detyrimet e përfitimeve pensionale mujore.

5.3 Pjesa e fondit të investueshëm përbëhet nga dy transhe si më poshtë:

a) Transhi i likuiditetit

Ky transh shërben për mbulimin e nevojave për likuiditet përtej atyre që mbulohen nga pjesa e fondit të përfitimeve. Madhësia e këtij transhi përcaktohet nga madhësia e fondeve të anëtarëve që iu ka lindur apo iu lind e drejta për pension në harkun kohor dyvjeçar. Kohëzgjatja e këtij transhi përcaktohet në bazë të dinamikës historike të tërheqjes të fondeve nga anëtarët që kanë tërhequr fonde.

b) Transhi i investimit

Ky transh përfaqëson gjendjen e mbetur si tepricë, pa përfshirë fondin e investueshëm që administrohet në transhin e likuiditetit. Kohëzgjatja e këtij transhi duhet të jetë në çdo kohë më e lartë se ajo e transhit të likuiditetit.

5.3 Komiteti përcakton të paktën një herë në vit madhësinë e secilit transh, kohëzgjatjen e secilit transh, si dhe kohën e lejuar për të arritur kohëzgjatjen e përcaktuar.

6. Instrumentet e investimit

Aktivitet e fondit të pensionit investohen në tituj të emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë të denominuar në Lekë.

7. Rreziqet e investimit dhe menaxhimi i tyre

7.1 Rreziku i kreditit dhe i shlyerjes

Për minimizimin e rrezikut të kreditit dhe të shlyerjes ndiqen kriteret e mëposhtme:

- a) instrumentet e lejuara të investimit janë në tituj të emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë;
- b) institucioni kujdestar është Banka;
- c) kryerja e veprimeve dhe ndjekja e tyre bëhet në sistemet e Bankës që janë të ndërtuara për minimizimin e këtij rreziku, duke ndjekur parimin e shlyerjes kundrejt pagesës.

7.2 Rreziku i likuiditetit

Për të minimizuar rrezikun e likuiditetit:

- a) fondi i pensionit strukturohet sipas përcaktimit në pikën 5;
- b) investimi në një ISIN të vetëm nuk mund të jetë më shumë se 70% e vlerës së transhit.

7.3 Rreziku i tregut

- a) Fondi investohet në mënyrë pasive me synim maksimizimin e kthimit në periudhën afatgjatë;
- b) Transhi i investimit mbahet deri në maturim dhe për rrjedhojë luhatjet e tregut nuk reflektohen.

7.4 Rreziqe të tjera

- a) Rreziku i agjencisë – minimizimi i rrezikut të agjencisë realizohet nëpërmjet menaxhimit të fondit nga strukturat përgjegjëse në Bankë të përcaktuara në rregulloren “Për Fondin e Pensionit”;
- b) Rreziku operacional – minimizohet përmes kontrolleve të vendosura në proceset që realizohen për investimin e fondit duke aplikuar parimin e katër syve.

8. Afati

Ky dokument nuk ka afat dhe rishikohet sa herë çmohet e nevojshme.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS

GENT SEJKO



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM
Nr. 29, datë 8.5.2024

**PËR
DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN "PËR KRAHASUESHMËRINË E
TARIFAVE TË LIDHURA ME LLOGARITË E PAGESAVE DHE PËR SHËRBIMIN E
TRANSFERIMIT TË LLOGARIVE TË PAGESAVE"**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja "a", dhe të nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të nenit 53, pika 4, nenit 55, pika 1, shkronja "e", të neneve 124 dhe 126 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; të ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020, "Për shërbimet e pagesave"; dhe të nenit 8, pika 3, nenit 14 dhe nenit 22 të ligjit nr. 100/2023, datë 14.12.2023, "Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike"; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Për krahasueshmërinë e tarifave të lidhura me llogaritë e pagesave dhe për shërbimin e transferimit të llogarive të pagesave", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 59, datë 21.12.2022, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Neni 1 ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

"Objekti i kësaj rregulloreje është:

- a) *përcaktimi i kërkesave për krahasueshmërinë dhe transparencën e tarifave që u ngarkohen konsumatorëve në llogaritë e tyre të pagesave dhe i kërkesave për transferimin e llogarive të pagesave ndërmjet ofruesve të shërbimeve të pagesave;*
- b) *përcaktimi i kërkesave për krahasueshmërinë dhe transparencën e tarifave që u ngarkohen konsumatorëve në llogaritë e tyre të*

- pagesave me shërbime bazike dhe i kërkesave për transferimin e llogarive të pagesave me shërbime bazike ndërmjet ofruesve të shërbimeve të pagesave; si dhe
- c) përcaktimi i metodologjisë së përlllogaritjes së tarifës së arsyeshme për shërbimet e ofruara në llogarinë e pagesave me shërbime bazike.”;
- b) Në nenin 2, pas togfjalëshit “ligjit nr.55/2020 “Për shërbimet e pagesave””, shtohet togfjalëshi “, si dhe bankat dhe degët e bankave të huaja, sipas ligjit nr. 100/2023 “Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike””;
- c) Neni 3, ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:
“Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a” dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të nenit 53, pika 4, nenit 55, pika 1, shkronja “e”, të neneve 124 dhe 126 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (më poshtë ligji “Për bankat”); të ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020, “Për shërbimet e pagesave” (më poshtë ligji “Për shërbimet e pagesave”) dhe të nenit 8, pika 3, nenit 14 dhe nenit 22 të ligjit nr. 100/2023, datë 14.12.2023, “Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike” (më poshtë ligji “Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike”).”;
- d) Në nenin 4 bëhen këto ndryshime:
- i. Pika 1, ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:
“1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar sipas nenit 4 të ligjit “Për bankat”, nenit 5 të ligjit “Për shërbimet e pagesave” dhe nenit 5 të ligjit “Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike”.”;
- ii. në pikën 2, pas shkronjës “a”, shtohet shkronja “a/1” me përmbajtjen e mëposhtme:
“a/1) “llogari e pagesave me shërbime bazike” - do të ketë të njëjtin kuptim si në ligjin “Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike”.”;
- iii. në pikën 2, shkronja “h”, togfjalëshi “në ligjin nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar”, zëvendësohet me togfjalëshin “në pikën 18 të nenit 5 të ligjit “Për shërbimet e pagesave”.”;
- e) Pas nenit 16, shtohet “KREU IV” dhe nenet 17 dhe 18 si pjesë përbërëse e Kreut IV, me përmbajtjen e mëposhtme:

“KREU IV KËRKESA PËR LLOGARINË E PAGESAVE ME SHËRBIME BAZIKE

Neni 17

Krahasueshmëria, transparenca e tarifave dhe transferimi i llogarive të pagesave me shërbime bazike

Kërkesat e kreut I, II dhe III të kësaj rregulloreje për llogarinë e pagesave, zbatohen në të njëjtën mënyrë nga bankat, edhe për llogarinë e pagesave me shërbime bazike, në zbatim të kërkesave të nenit 14 të ligjit “Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike”.

Neni 18

Metodologjia e përlllogaritjes së tarifës së arsyeshme për shërbimet e ofruara në llogarinë e pagesave me shërbime bazike

Bankat, në përlllogaritjen e tarifës së arsyeshme për shërbimet e ofruara në llogarinë e pagesave me shërbime bazike, siç parashikohet në nenin 8, pika 3 të ligjit “Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike”, bazohen në nivelin mesatar të tarifës së aplikuar nga banka, për të njëjtat shërbime të ofruara nëpërmjet një llogarie pagesash dhe në çdo rast tarifa e arsyeshme nuk tejkalon 50% të këtij niveli mesatar.”;

- f) Kreu IV “Dispozita të fundit”, rinumërohet si Kreu V;
 - g) Neni 17 dhe neni 18, rinumërohen përkatësisht si neni 19 dhe neni 20;
 - h) Në nenin 19 të rinumërtuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - i. titulli i nenit “Ankesat e klientëve”, zëvendësohet me titullin “Ankesat e konsumatorëve”;
 - ii. pas togfjalëshit “për zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve”, shtohet togfjalëshi “, përfshirë edhe ankesat në lidhje me llogarinë e pagesave me shërbime bazike.”;
 - i) Në nenin 20 të rinumërtuar, pas togfjalëshit “në ligjin “Për shërbimet e pagesave””, shtohet togfjalëshi “, në ligjin “Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike””.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
 3. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare

të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

SEKRETARI

KRYETARI

ELVIS ÇIBUKU

GENT SEJKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM
Nr. 30 datë 8.5.2024

PËR
DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN "PËR SIGURINË E INFORMACIONIT"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja "f" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; me propozim të Departamentit të Teknologjisë së Informacionit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Për sigurinë e informacionit", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 17, datë 9.3.2011, i ndryshuar, bëhen ndryshimet në nenin 20, si më poshtë:
 - a) Në pikën 1, togfjalëshi "Pajisjet që përpunojnë informacionin" zëvendësohet me togfjalëshin "Pajisjet që përpunojnë, ruajnë ose transmetojnë informacionin";
 - b) Shtohet pika 5 me përmbajtje si vijon:

"5. Të gjitha pajisjet (apo pjesë përbërëse të tyre ku ruhet informacion), përfshirë mediat e lëvizshme, para se të nxirren jashtë përdorimit ose të ripërdoren, duhet të verifikohen për t'u siguruar që informacioni që përmbajnë të jetë hequr, mbishkruar ose fshirë. Fshirja e informacionit dhe/ose shkatërrimi i pajisjeve (apo pjesëve përbërëse) duhet të kryhet me mënyra të përshtatshme që të mos jetë i mundur ekspozimi apo rikthimi i informacionit në to."
2. Ngarkohen të gjitha njësitë organizative të Bankës së Shqipërisë me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM
Nr. 31, datë 8.5.2024

**PËR
NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT MBIKËQYRËS
NR. 17, DATË 23.3.2023 "PËR MIRATIMIN E KONFIGURIMEVE TË
VIZATIMEVE TË MONEDHËS PËRKUJTIMORE, QË DO TË SHTYPET PËR
QËLLIME NUMIZMATIKE NË VITIN 2023"**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 39, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; nenit 16, pika 3, shkronja "d" të rregullores "Për procedurat e krijimit dhe shtypjes së monedhave dhe kartëmonedhave pa kurs ligjor, përkujtimore për qëllime numizmatike, dhe medaljoneve përkujtimore nga Banka e Shqipërisë", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 12, datë 7.2.2024; si dhe bazuar në propozimin e Departamentit të Kërkimeve, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.17, datë 23.3.2023 "Për miratimin e konfigurimeve të vizatimeve të monedhës përkujtimore, që do të shtypet për qëllime numizmatike në vitin 2023" të miratojë shtimin e tirazhit të monedhave përkujtimore numizmatike 100 Lekë nga 500 copë në 502 copë, nga të cilat shtohet Fondi për Muze me monedhën "Provë" nga 1 (një) copë në 2 (dy) copë monedha provë dhe Fondi numizmatik për shitje nga 385 copë në 386 copë.
2. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me zbatimin e këtij vendimi dhe publikimin e tij në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
GUVERNATORI

Nr. 2302 prot.

Tiranë, më 23.5.2024

VENDIM
Nr. 2302, datë 23.5.2024

PËR
REVOKIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT FINANCIAR JOBANKË
"MICRO CREDIT ALBANIA" SH.P.K.

Sot, më datë 23.5.2024, u njoha me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, përcjellë me shkresën nr.3623, datë 23.5.2024, me objekt "Revokimin e licencës së subjektit financiar jobankë "MICRO CREDIT ALBANIA" sh.p.k.". Nga shqyrtimi i relacionit, si dhe të analizës së bërë për propozimin, duke vlerësuar të gjitha shkaqet e përmendura aty,

VËREJ:

Subjekti financiar jobankë "MICRO CREDIT ALBANIA" sh.p.k. është licencuar për kryerjen e të gjitha formave të kredidhënies dhe shërbimet këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbime të tjera ndihmëse për veprimtarinë e kredidhënies, sipas licencës së dhënë nga Banka e Shqipërisë me nr. 38, datë 9.5.2016, pezulluar me vendimin nr. 644, datë 6.2.2024.

Në bazë dhe për zbatim të rregullores nr. 1, datë 17.1.2013 "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka", e ndryshuar, neni 10, pika 1, shkronja "a", një nga kriteret që duhet të plotësojnë në vazhdimësi subjektet financiare jobanka gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, është që themeluesit e subjektit të kenë reputacion të mirë.

Bazuar në informacionin e marrë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me shkresën me nr. prot. 12287/1, datë 23.5.2024, jemi vënë në dijeni të faktit se ndaj ortakut të vetëm të subjektit financiar jobankë "MICRO CREDIT ALBANIA" sh.p.k., Elda Ibro, është vendosur masa e sigurimit personal

“arrest në shtëpi” nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Mbështetur në sa më sipër, Departamenti i Mbikëqyrjes vlerëson se jemi në kushtet e parashikuara në nenin 14, pika 1, shkronja “h”, të rregullores së mësipërme, cit.: “... Banka e Shqipërisë mund të pezullojë ose revokojë licencën e subjektit financiar jobankë, në rast se nuk përmbush më kushtet në bazë të të cilave ai është licencuar”, dhe propozon revokimin e licencës së subjektit “MICRO CREDIT ALBANIA” sh.p.k.

Në përfundim, duke vlerësuar se propozimi i Departamentit të Mbikëqyrjes është i argumentuar, bazuar në nenin 14, pika 1, shkronja “h” të rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 17.1.2013 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar, si dhe të shtojcës nr.3, pika 4 të rregullores “Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare”, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.36, datë 26.5.2010, i ndryshuar;

VENDOSA:

1. Revokimin e licencës së aktivitetit të shoqërisë “MICRO CREDIT ALBANIA” sh.p.k. për kryerjen e të gjitha formave të kredidhënies dhe shërbimet këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbime të tjera ndihmëse për veprimtarinë e kredidhënies.
2. Shoqëria “MICRO CREDIT ALBANIA” sh.p.k. ka të drejtë të paraqesë ankim pranë Guvernatorit brenda 15 ditëve sipas parashikimeve të nenit 93 të Ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
4. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në Buletin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

GUVERNATOR

GENT SEJKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
GUVERNATORI

Nr. 2303 prot.

Tiranë, më 23.5.2024

VENDIM
Nr. 2303, datë 23.5.2024

PËR
REVOKIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT FINANCIAR JOBANKË
"FINAL" SH.P.K.

Sot më datë 23.5.2024, u njoha me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, përcjellë me shkresën me nr. 3624, datë 23.5.2024, me objekt "Revokimin e licencës së subjektit financiar jobankë "FINAL" sh.p.k.". Nga shqyrtimi i relacionit, si dhe të analizës së bërë për propozimin, duke vlerësuar të gjitha shkaqet e përmendura aty,

VËREJ:

Subjekti financiar jobankë "FINAL" sh.p.k. është licencuar për kryerjen e veprimtarive të qirasë financiare dhe të të gjitha formave të kredidhënies, sipas licencës së dhënë nga Banka e Shqipërisë me nr. 11, datë 20.2.2009.

Në bazë dhe për zbatim të rregullores nr. 1, datë 17.1.2013 "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka", e ndryshuar, neni 10, pika 1, shkronja "a", një nga kriteret që duhet të plotësojnë në vazhdimësi subjektet financiare jobanka gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, është që themeluesit e subjektit të kenë reputacion të mirë.

Bazuar në informacionin e marrë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me shkresën me nr. prot. 12287/1, datë 23.5.2024, jemi vënë në dijeni të faktit se ndaj ortakut të vetëm të subjektit financiar jobankë "FINAL" sh.p.k., Arben Meskuti, është vendosur masa e sigurimit personal "arrest me burg" nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Mbështetur në sa më sipër, Departamenti i Mbikëqyrjes vlerëson se jemi në kushtet e parashikuara në nenin 14, pika 1, shkronja "h", të rregullores së mësipërme, cit.: "... Banka e Shqipërisë mund të pezullojë ose revokojë licencën e subjektit financiar jobankë, në rast se nuk përmbush më kushtet në bazë të të cilave ai është licencuar", dhe propozon revokimin e licencës së subjektit "FINAL" sh.p.k.

Në përfundim, duke vlerësuar se propozimi i Departamentit të Mbikëqyrjes është i argumentuar, bazuar në nenin 14, pika 1, shkronja "h" të rregullores "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka", miratuar me vendimin nr. 1, datë 17.1.2013 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar, si dhe të shtojcës nr.3, pika 4 të rregullores "Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare", miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.36, datë 26.5.2010, i ndryshuar;

VENDOSA:

1. Revokimin e licencës së aktivitetit të shoqërisë "FINAL" sh.p.k. për veprimtarinë e qirasë financiare dhe kryerjen e të gjitha formave të kredidhënies.
2. Shoqëria "FINAL" sh.p.k. ka të drejtë të paraqesë ankim pranë Guvernatorit brenda 15 ditëve sipas parashikimeve të nenit 93 të Ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
4. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

GUVERNATOR

GENT SEJKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
GUVERNATORI

Nr. 2454 prot.

Tiranë, më 4.6.2024

URDHËR
Nr. 2454, datë 4.6.2024

PËR
HEDHJEN NË QARKULLIM TË MONEDHAVE METALIKE SHQIPTARE, ME
KURS LIGJOR, ME VLERË NOMINALE 5 LEKË

Në bazë dhe për zbatim të nenit 36 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të nenit 11 pika 6 të Statutit të Bankës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr. 90, datë 02.12.2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, i ndryshuar; të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 2, datë 18.1.2023 "Për rishtypjen e monedhave metalike shqiptare, me kurs ligjor, me prerje 5 Lekë, 10 Lekë dhe 100 Lekë"; të nenit 17, të rregullores "Për shtypjen, rishtypjen, hedhjen dhe tërheqjen nga qarkullimi të kartëmonedhave dhe monedhave metalike shqiptare me kurs ligjor", miratuar me vendimin nr.133, datë 7.12.2016 të Këshillit Mbikëqyrës; si dhe bazuar në propozimin e Departamentit të Emisionit,

URDHËROJ:

1. Hedhjen në qarkullim të monedhave metalike shqiptare me kurs ligjor, me vlerë nominale 5 Lekë, emetim i vitit 2023, duke filluar nga data 20 qershor 2024.
2. Me zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Departamenti i Emisionit.
3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

GUVERNATOR

GENT SEJKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM
Nr. 32, datë 5.6.2024

PËR
MIRATIMIN E LIRIMIT NGA DETYRA TË DREJTORIT TË DEPARTAMENTIT PËR
NDËRHYRJEN E JASHTËZAKONSHME TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Në bazë të nenit 43, shkronja "h" të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" i ndryshuar; nenit 17, pika 3 të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr.90, datë 2.12.2015 "Për miratimin e statutit të Bankës së Shqipërisë", i ndryshuar; nenit 62, pika 1 të rregullores "Për marrëdhëniet e punës të personelit të Bankës së Shqipërisë", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.21, datë 16.5.2007, e ndryshuar; kërkesës për dorëheqje nr.prot.2439 datë 3.6.2024, me propozim të Departamentit të Burimeve Njerëzore, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e lirimit të zj.Vasilika Kota nga detyra e Drejtorit të Departamentit për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme të Bankës së Shqipërisë.
2. Ngarkohet Departamenti i Burimeve Njerëzore me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM
Nr. 33, datë 5.6.2024

**PËR
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN
"PËR LICENCIMIN DHE USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NGA SUBJEKTET
FINANCIARE JOBANKA"**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja "b", nenit 12, shkronja "a" dhe të nenit 43, shkronja "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; dhe të nenit 126 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 1, datë 17.1.2013, e ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - a) Titulli i rregullores ndryshon si vijon:

"PËR LICENCIMIN, USHTRIMIN E VEPRIMTARISË, REVOKIMIN E LICENCËS DHE LIKUIDIMIN E PORTOFOLIT TË KREDIVE TË KRIJUAR NGA USHTRIMI I VEPRIMTARISË FINANCIARE NGA SUBJEKTET FINANCIARE JOBANKA"
 - b) Në nenin 1, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - i. Pas shkronjës "d", shtohen shkronjat "e" dhe "f", përkatësisht me përmbajtjen e mëposhtme:
 - "e) revokimin e licencës së subjekteve financiare jobanka për të ushtruar veprimtari financiare në Republikën e Shqipërisë;
 - f) likuidimin e portofolit të kredive të krijuar nga ushtrimi i veprimtarisë financiare në bazë të licencës të subjektit financiar jobankë."

- c) Në nenin 2, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
- i. Pas shkronjës "d", shtohen shkronjat "e" dhe "f", përkatësisht me përmbajtjen e mëposhtme:
 - "e) ligji nr.9901 datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar;
 - f) ligji nr. 110/2016, datë 27.10.2016 "Për falimentimin".";
- d) Në nenin 4, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
- i. Pika 1 e nenit 4 ndryshon, si vijon:
"1. Për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e përkufizuar në nenin 4 të Ligjit për bankat, të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, të Ligjit për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare dhe të Ligjit për Falimentimin, kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë rregullore."
 - ii. Pas shkronjës "n" shtohet shkronja "o" me përmbajtjen si vijon:
"likuidim i portofolit të kredive të krijuar nga ushtrimi i veprimtarisë financiare në bazë të licencës" – në kuptim të kësaj rregulloreje, është procesi i administrimit të portofolit të kredive, të subjektit financiar jobankë, të krijuar nga subjekti financiar jobankë, si rrjedhojë e veprimtarisë financiare të ushtruar sipas licencës së dhënë nga Banka e Shqipërisë (më poshtë referuar si "likuidimi")."
- e) Pas nenit 21 shtohet Nënkreu IV, me përmbajtjen e mëposhtme:

"NENKREU IV

Neni 21/1

Revokimi i licencës dhe likuidimi i subjektit financiar jobankë

1. Banka e Shqipërisë, në rast të revokimit të licencës së subjektit financiar jobankë sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje, fillon menjëherë procesin e likuidimit të portofolit të kredive të krijuar nga ushtrimi i veprimtarisë financiare në bazë të licencës.
2. Likuidimi sipas pikës "i" të këtij neni, nuk zbatohet në rastet kur subjektit financiar jobankë i është revokuar licenca me kërkesën e tij dhe nuk ka portofol kredish në bilancin e vet, ose për arsye se nuk ka ushtruar aktivitetin për të cilin është licencuar, ose aktiviteti i tij është në një masë të tillë, sipas përcaktimeve të Bankës së Shqipërisë, që nuk përbën rrezik për të drejtat e kredimarrësve.
3. Banka e Shqipërisë, nëse konstaton ekzistencën e rasteve të prishjes së shoqërisë sipas parashikimeve të ligjit 9901 datë

14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", mund t'i drejtohet gjykatës për të vendosur prishjen e shoqërisë dhe në vijim mund të kërkojë caktimin e likuiduesve, nëse janë kushtet e nenit 191 të këtij ligji.

Neni 21/2 **Likuidimi dhe emërimi i likuidatorit**

1. Banka e Shqipërisë, pas revokimit të licencës për subjektet financiare jobanka, fillon procesin e likuidimit sipas kësaj rregulloreje, pavarësisht se subjekti është në gjendjen e aftësisë paguese.
2. Banka e Shqipërisë bashkëpunon me Ministrinë e Drejtësisë për emërimin e likuidatorit nga lista e administratorëve të falimentimit, ose persona të tjerë të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenet 112 dhe 113 të Ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".
3. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të shkarkojë likuidatorin ose likuidatorët, në rast të mospërbushjes së detyrave të tyre.
4. Njoftimi për vendosjen në likuidim të portofolit të kredive të subjektit financiar jobankë të cilit i është revokuar licenca, botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë.

Neni 21/3 **Grupi i punës**

1. Guvernatori urdhëron krijimin e grupit të punës.
2. Departamenti i Mbikëqyrjes dhe grupi i punës dhe kanë si detyrë kryesore të mbështesin likuidatorin në procesin e likuidimit, duke përgatitur paketën fillestare të informacionit për likuidatorin me informacionet e disponueshme nga raportimet e subjektit në Bankën e Shqipërisë, me qëllim njohjen e situatës financiare të subjektit të vendosur në likuidim.

Neni 21/4 **Bashkëpunimi i likuidatorit me Bankën e Shqipërisë**

1. Likuidatori raporton pranë Bankës së Shqipërisë mbi ecurinë e procesit të likuidimit në baza periodike, minimalisht një herë në muaj dhe sa herë të kërkohet nga Banka e Shqipërisë.
2. Likuidatori kryen ose autorizon përditësimet e kredimarrësve të subjektit financiar jobankë në Regjistrin e Kredive.

3. Paga e likuidatorit dhe shpenzimet për ushtrimin e funksioneve të tij përballohen nga subjekti, të cilit i është revokuar licenca.

Neni 21/5 **Efektet e fillimit të likuidimit**

1. Likuidatori ka të drejtë që pas revokimit të licencës dhe me fillimin e likuidimit të administrojë portofolin e kredive të subjektit financiar jobankë. Në rast shitjeje të portofolit, shitja kryhet nëpërmjet ankandit.
2. Likuidatori merr të gjitha masat për likuidimin e portofolit të kredive të subjektit financiar jobankë, përfshirë dhe ruajtjen e evidencave (elektronikisht ose të mbajtura në formate të tjera).

Neni 21/6 **Detyrat dhe kompetencat e likuidatorit**

Likuidatori ushtron kompetencat e përcaktuara në Ligjin "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", për aq sa është e përshtatshme për likuidimin e portofolit të kredive të subjekteve financiare jobanka.

Neni 21/7 **Plani i likuidimit**

1. Likuidimi i portofolit të kredive të krijuar në bazë të licencës së dhënë nga Banka e Shqipërisë bëhet në përputhje me planin e likuidimit.
2. Plani i likuidimit hartohet duke mbajtur në konsideratë mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit sipas legjislacionit në fuqi.
3. Plani i likuidimit hartohet nga likuidatori brenda afatit të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë.
4. Plani i likuidimit depozitohet për miratim në Bankën e Shqipërisë. Departamenti i Mbikëqyrjes mund të paraqesë komente dhe vërejtje për planin e likuidimit, brenda 10 ditëve nga data e depozitimit të tij në Bankën e Shqipërisë.

Neni 21/8 **Përfundimi i likuidimit**

1. Pas likuidimit të portofolit të kredive, likuidatori njofton Bankën e Shqipërisë për përfundimin e tij.
2. Raportet e përgatitura nga likuidatori dorëzohen në Bankën e Shqipërisë.

Neni 21/9
Raportimi në Regjistrin e Kredive

Likuidatori raporton në Regjistrin e Kredive të gjitha kreditë financiare, në varësi të dokumentacionit të gjetur dhe të ecurisë së procesit të likuidimit.”.

2. Përcaktimet e këtij vendimi zbatohen edhe për subjektet financiare jobanka, të cilëve iu është revokuar licenca.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
4. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

SEKRETARI

KRYETARI

ELVIS ÇIBUKU

GENT SEJKO

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR, VËLLIMI 26, NUMËR 1, JANAR 2024

1. Licencë nr. 55, datë 3.11.2023, "Për të vepruar si institucion i parasë elektronike në Republikën e Shqipërisë"
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 2, datë 24.1.2024, për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit për Sistemet e Pagesave"
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 3, datë 24.1.2024, "Për miratimin e disa ndryshimeve në kontratën tip për riblerjen e titujve"
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 5, datë 24.1.2024 "Për miratimin e Strategjisë të Bankës së Shqipërisë "Për krijimin e monedhave pa kurs ligjor, përkujtimore dhe për qëllime numizmatike për 2024-2029""
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 6, datë 24.1.2024 "Për miratimin e Strategjisë të Bankës së Shqipërisë për edukimin dhe përfshirjen financiare, 2024-2026"
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 7, datë 24.1.2024 "Për miratimin e delegimit të kompetencës për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bankës së Shqipërisë dhe Akademisë së Sigurisë"

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR, VËLLIMI 26, NUMËR 2, SHKURT 2024

1. Vendim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, nr. 644, datë 6.2.2024 "Për pezullimin e licencës së subjektit financiar jobankë "Micro Credit Albania""
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 9, datë 7.2.2024 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë""
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.10, datë 7.2.2024, "Për miratimin e udhëzimit "Për raportimin e incidenteve madhore"
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.11, datë 7.2.2024 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare""
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 12, datë 7.2.2024, "Për miratimin e rregullores "Për procedurat e krijimit dhe shtypjes së monedhave dhe kartëmonedhave pa kurs ligjor, përkujtimore për qëllime numizmatike, dhe medaljoneve përkujtimore nga Banka e Shqipërisë""

**TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR, VËLLIMI 26, NUMËR 3, PRILL
2024**

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 15, datë 6.3.2024 "Për një ndryshim në rregulloren "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit""
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 16, datë 6.3.2024 "Për shtypjen e monedhës metalike përkujtimore, për qëllime numizmatike, me tematikë "100 vjet Banka e Shqipërisë, 1925-2025""
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 17, datë 20.3.2024 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë".
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 18, datë 20.3.2024 "Për miratimin e pasqyrave financiare të Bankës së Shqipërisë për vitin 2023"
5. Vendim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, nr.prot. 1481, datë 2.4.2024 "Për caktimin e shtesave makroprudenciale të kapitalit"
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 21, datë 3.4.2024 "Për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e kërkesave për transfertat e kreditit dhe të debitimit direkt në Euro""
7. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 24, datë 3.4.2024 "Për rishtypjen e kartëmonedhës shqiptare me kurs ligjor, me prerje 200 Lekë dhe 500 Lekë"